



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Gjimnazi “Hivzi Sulejmani” në Fushë - Kosovë

Adresa: Rruga “Aziz Zhilivoda” Nr.

Tel: 038/534 -796

Nr. i Protokollit :108 /22

OFERTË PËR EKSKURSION

Gjimnazi “HIVZI SULEJMANI” në Fushë - Kosovë bënë organizimin e Ekskursionit të Maturantëve për në Republikën e Shqipërisë bazuar në Udhëzimin Administrativ për Aktivitetet Jashtëshkollore Nr. 02/2016 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

Ftojme agjencitë turistike të licencuara që të konkurrojnë për organizimin e Ekskursionit në Republikën e Shqipërisë për maturantët e Gjimnazit “HIVZI SULEJMANI” në Fushë - Kosovë.

Në ofertë të parashihet çmimi, pastaj akomodimi në Hotel i cili përfshinë fjetjen, sigurinë fizike, sigurinë shëndetësore, ushqimin cilësor e kalorik, shërbimin 24 orësh mjekësor, transportin dhe shpenzimet e tjera që paraqiten me rastin e vizitave në pika monumente dhe vende (qytete) të ndryshme historike.

Sigurimi i transportit të nxënësve dhe akomodimi i tyre bëhet në hotel sipas marrëveshjes dhe kontratës në mes të shkollës dhe agjencionit pas mbylljes së ofertave dhe shpalljes së agjencionit fitues. Realizimi i ekskursionit do të bëhet në periudhën kohore nga data, 16.05.2022 deri me datën 20.05.2022.

Kohëzgjatja e ekskursionit dhe qëndrimit (në Durrës) do të jetë pesë ditë, katër buajtje në ditën e pestë kthimi për në Fushë - Kosovë.

Nisja e nxënësve maturant me autobus:

Stacioni Hekurudhor në Fushë - Kosovë, me dt. 16.05.2022 nga ora 07:30.

Agjencioni duhet të përmbahet të gjitha obligimeve që dalin nga Udhëzimi Administrativ i MASHT-it, Nr. 02/ 2016 dhe Këshillit Drejtues të Shkollës.

Agjencionet turistike në ofertën e tyre duhet t'i plotësojnë këto parakushte:

1. Agjencioni të ketë licencën sipas Ligjit mbi transportin me të drejtë qarkullimi jashtë shtetit,
2. Autobuset të jenë komfor dhe me klimë,
3. Agjencioni të ketë bërë kontrollimin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore dhe teknike – (Ofertës t'i bashkëngjiten dëshmitë për të gjithë autobusët që do të përdoren në ekskursion me nxënës)
4. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës (ekskursionit) dhe dëshmi të shërbimit teknik,

5. Agjencioni duhet të ketë dëshmitë (fotokopje) librezat e autobusëve,
6. Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin psiko-fizik të ngasësve (shoferëve) të autobusëve,
7. Agjencioni duhet të siguron përkujdesje dhe shërbime mjekësore për nxënësit gjatë tërë kohëzgjatjes së ekskursionit, dëshminë e certifikatës dhe kontratën e punës së mjekut,
8. Rezervimi i hotelit (dëshmi origjinale e vulosur) dhe në bashkëpunim me Hotelin të ofrojë siguri 24 orëshe për nxënësit dhe personelin përcjellës,
9. Agjencioni duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (licenca të jetë e vërtetuar edhe nga pronari i hotelit).

Dorëzimi: Dokumentacioni me oferta në emër të shkollës dorëzohet në dy kopje; njëra kopje tek zyrtari administrativ (sekretari-ja) e shkollës në - Katin e Parë, në objektin e Gjinnazit "Hivzi Sulejmani" në Fushë-Kosovë dhe kopja tjetër në zyrat e DKA-së, Objekti i Komunës në Katin e Parë deri më 12.05.2022 (e enjte), në ora 15.00. Afati i paraqitjes së ofertave me të gjitha dëshmitë dhe dokumentacionin është shtatë (7) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Web-faqe zyrtare të Komunës së Fushë - Kosovës.

Pas shqyrtimit të ofertave nga ana e komisionit në përbërje prej tre anëtarësh (një përfaqësues i autorizuar nga DKA-ja, Kryetari ose një përfaqësues tjetër i Këshillit të Shkollës dhe drejtori i shkollës) do të përzgjidhet oferta me e favorshme dhe e cila plotëson kushtet e kërkuara.

Hapja e ofertave: Ofertat do të hapën me të skaduar afati më datë: 12.05.2022 (e enjte), në ora 15:00 në objektin e gjinnazit.

Ofertuesi i përzgjedhur nga komisioni i merr të gjitha obligimet sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2016 për organizimin e ekskursionit.

Datë: 04.05.2022

Drejtori i shkollës: Msc.: Amir Pllana

